



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.07.2025 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "BABITA " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dysHEMEVE dhe blerja e gjeneratorëve në shkollë ", Nr. i prokurimit- 632-25-1876-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-023-121, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "BABITA" SH.P.K., e dt.07.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dysHEMEVE dhe blerja e gjeneratorëve në shkollë ", Nr. i prokurimit- 632-25-1876-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-023-121,, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 02.06.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **02.06.2025;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "BABITA" SH.P.K., me dt.07.07.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me makina korrëse të barit, kazanit dhe elementeve tjera të kuzhinës në konvikt, makinave për pastrimin e dysHEMEVE dhe blerja e gjeneratorëve në shkollë", Nr. i prokurimit- 632-25-1876-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-023-121,.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.07.2025, pasi ka rishikuar ofertën tuaj, ka shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pabazuara. Autoriteti kontraktues ju ka eliminuar sepse ju në ofertën tuaj keni prezantuar katalogun në të cilin për pozicionin 1 keni prezantuar korrëse bari me benzinë dhe ndezje me buton, keni prezantuar motorin me 4.5kv ndërsa është kërkuar motori me 3.0kv. Ju gjithashtu keni prezantuar gjerësinë e kositjes me 53 cm, ndërsa është kërkuar me 51 cm. Keni prezantuar koshin e mbeturinave me 62 litra ndërsa është kërkuar me 55 litra. Në katalogun e prezantuar për pozicionin me numër rendor 5, keni prezantuar gjenerator dizel i cili nuk është konform kërkesave të Autoritetit kontraktues, për arsye se është kërkuar që i njëjti të ketë një dalje tre fazore dhe 2 dalje monofaz kurse ju e keni prezantuar me 1 dalje tre fazore dhe 1 dalje monofaz.

Ju nuk keni prezantuar ISO 9001:2015, ISO 22000:2005 dhe Certifikatën CE

Oferta juaj nuk ka qenë konform specifikave të kërkuara nga Autoriteti kontraktues, prandaj edhe jeni eliminuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
